

STATUTI I SHOQERISE UNLOCKED.AL Sh.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar UNLOCKED.AL themelohet ne perputhje me ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" nga ortaket Krist Hasanbega dhe Juxhin Marku.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 15 Maj 2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin UNLOCKED.AL SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë :

1. Krist Hasanbega, i biri i Hakiut, lindur me 12.05.1996 ne Vlorë, banues ne Vlorë, Rruga Demokracia 04140080; Nd. 16; H. 5; Ap. 7; Vlorë; Vlorë; 9402; Vlorë, me karte identiteti ID nr. **BR1364044 dhe nr. personal J60512086K.**
2. Juxhin Marku, i biri i Kastriotit, lindur me 06.08.1994 ne Fier, banues ne Tiranë, rruga Zef Jubani (Pll Merkaj); Nd. 1829; H. 0; Ap. 010; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia bashkiake nr. 5; 1019; Tiranë, me karte identiteti ID nr. 033226574 **dhe nr. Personal J40806091A.**

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitet shërbimi e tregtimi nëpërmjet nje platforme digjitale turistike per ofrim të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme ne funksion te turizmit ne Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por jo i kufizuar në tregtimin e biletave për udhëtime turistike, rezervime hoteliere, etj.

Karta dhe platforma janë projektuar për të shërbyer interesave të turistëve (konsumatorëve), duke u mundësuar atyre qasje në ulje dhe oferta turistike nga subjektet apo individët tregtarë brenda Republikës së Shqipërisë. Përveç kësaj, përmes kësaj karte dhe platforme, ata do të jenë të informuar rreth eventeve dhe organizimeve turistike.

Shoqëria do të ofrojë shërbime marketingu të larmishme për bizneset dhe individë tregtare, duke përfshirë marketingun dixhital, optimizimin SEO, menaxhimin e medias sociale, dhe fushatat e marketingut me sms dhe email. Do të ofrohet gjithashtu menaxhim i sigurisë kibernetike, menaxhim i projekteve, dhe orientim për karrierën dhe sipërmarrësve të rinj.

Aktivitetet do të përfshijnë programimin kompjuterik, zhvillimin e aplikacioneve, robotikën, elektronikën, dhe shkencën e të dhënave. Do të përfshihet gjithashtu testimi dhe dizajni i software-ve, dhe dizajni i faqeve web dhe i përvojës së përdoruesit.

E gjithë veprimtaria e shoqërisë, pavarësisht nga objekti i saj, do të mbështetet në licensat e lëshuara për këtë qëllim nga organi shtetëror përkatës kur një e tillë kërkohet nga legjislacioni.

Shoqëria do të bashkëpunojë me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh, hotele, resorte, restorante, dhe subjekte të tjera vendase dhe/ose të huaja që kanë objekt veprimtarie të njëjtë ose që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë. Import-Eksport, tregeti me shumice e pakice e të tjere.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga dita e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Bisnesit.

Neni 4:

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Vlore, Lagjja “Osman Haxhiu”, Rruga “Demokracia”, Pallati Nr.1322, Kati 3, Vlore.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është me dy kuota me vlerë të përgjithshme 100 Lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Krist Hasanbega: Ka një kuotë me vlerë të përgjithshme 80 leke që përben 80% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Juxhin Marku: Ka një kuotë me vlerë të përgjithshme 20 leke që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100 leke

Vlera e paguar: 0

Kontributet në para do të paguhen, menjëherë pas regjistrimit në QKR, në llogarinet bankare që do hapet në emër të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga asamblëja e përgjithshme, e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asamblëja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit aksionar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit aksionar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, pas miratimit në asamblëne e përgjithshme të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asamblëja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asamblëja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asamblëja e përgjithshme e ortakëve merr vendime për çështjet e mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë për një periudhë 5-vjecare nga momenti i regjistrimit në QKB.

1. Krist Hasanbega, i biri i Hakiut, lindur me 12.05.1996 në Vlorë, banues në Vlorë, Rruga Demokracia 04140080; Nd. 16; H. 5; Ap. 7; Vlorë; Vlorë; 9402; Vlorë, me kartë identiteti ID nr. **BR1364044** dhe nr. personal **J60512086K**.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanëjë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit , Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti emerohet nga asambleja e ortakëve per auditimin e pasqyrave financiare kur kerkohet nga ligji apo detyra te tjera qe caktohen nga aksioneret.

Ne perfundim të auditimit apo kryerjes se detyrave te caktuara nga ortakët, eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim dhe është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe kane.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- me vendim të gjykatës.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqëri ne likuidim e sipër “.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

UNLOCKED.AL

Krist Haki Hasanbega



Juxhin Kastriot Marku

